




KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina



KOLEGJI "PJETËR BUDI" - PRISHTINË

RREGULLORE PËR PARLAMENTIN STUDENTOR

Prishtinë, 2020



Në bazë të nenit 104 te Statutit të Kolegjit "Pjetër Budi, Bordi Drejtues i Kolegjit me datë 22.12. 2020, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PARLAMENTIN STUDENTOR

Neni 1

Profili i Parlamentit

Parlamenti studentor është organizatë e studentëve, i cili është i përkushtuar në çështjet edukative, interesat e studentëve si dhe mirëqenien e tyre.

Parlamenti studentor njihet me emrin Parlamenti Studentor i Kolegjit Pjeter Budi.

Parlamenti i studentëve përfaqëson studentët brenda dhe jashtë kolegjit. Organizon ngjarje dhe aktivitete me interes të studenteve e të cilat lidhen me mundësit e zhvillimit të tyre.

Parlamenti gjatë tërë kohës kërkon që të ketë diversitet dhe barazi të anëtareve pa dallime gjinore, fetare, politike, sociale dhe orientimit seksual.

Parlamenti Studentor do të punojë për të mbrojtur dhe rritur të drejtën e studentëve për fjalën e lirë.

Neni 2

Organizimi i studentëve

Studentet kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët.

Secila organizatë studentore ka statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj në pajtim me rregulloret e përgjithshme të nxjerra nga Bordi Drejtues. Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim.



Neni 3

Organet e përfaqësimit të studenteve

Interesat e studentëve do të përfaqësohen në kuadër të Kolegjit me këto organe:

- Parlamenti i studentëve në nivel të Kolegjit;
- Këshilli i studentëve në nivel të Programeve Studimore.

Neni 4

- Anëtarët për Parlamentin e studentëve dhe këshillat e studentëve do të zgjidhen në pajtim me procedurat për zgjedhje parlamentare.
- Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin e studentëve dhe këshillin e studentëve të Programit Studimor në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.
- Mandati i anëtarëve të Parlamentit të studentëve dhe këshillit të studentëve të Programit Studimor zgjat 2 vjet, pa te drejte te rizgjedhjes.
- Parlamenti i studentëve dhe këshillat e studentëve të Programeve Studimore ushtrojnë detyra në bazë të parimit të shumicës votave.

Neni 5

- Parlamenti i studentëve është organi suprem i përfaqësimit të studentëve.
- Numri i tërësishëm i anëtarëve të parlamentit të studentëve është 7.
- Anëtarët propozohen nga organizatat studentore në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritura në zgjedhjet e studentëve dhe sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga secila organizatë studentore në fillim të fushatës zgjedhore.
- Anëtarët e Parlamentit të studentëve zgjedhin kryetarin dhe nënkryetarin.
- Bordi Drejtues nxjerr rregulloren e punës për parlamentin e studentëve.
- Parlamenti i studentëve zgjedh anëtarët e Senatit nga lista e të propozuarve e përgatitur nga këshilli i studentëve i Programit Studimor. Kryetari i Parlamentit të Studentëve është anëtar exofficio nga numri i përgjithshëm i anëtarëve studentë të Senatit.

Neni 6

- Këshillat e studentëve janë organet e përfaqësimit të studentëve në secilën program studimor.
- Numri i përgjithshëm i anëtarëve të secilit këshill të studentëve është 1% i numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në atë program studimor, me më së paku 1 dhe më së shumti 3 anëtarë.



- Anëtarët do të propozohen nga organizata studentore në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të arritur gjatë zgjedhjeve të studentëve për secilën program studimor sipas listave prioritare të kandidatëve të publikuara nga organizata studentore në fillim të fushatës zgjedhore.
- Anëtarët e secilit këshill të studentëve zgjedhin një kryetar dhe një nënkryetar.
- Secili këshill i studentëve propozon listën e kandidatëve për anëtarë studentë të Senatit për tu zgjedhur nga Parlamenti i Studentëve.

Neni 7

Bordi drejtues i ndan një buxhet të përshtatshëm vjetor për veprimtarinë e Parlamentit të studentëve dhe këshillave të studentëve të propozuar nga Parlamenti i Studenteve.

Neni 8

Studentët kanë të drejtë për tubime paqësore.

Neni 9

Studentët kanë të drejtë të formojnë asociacione profesionale apo shoqata për çfarëdo qëllimi të lejuar me Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.

Neni 10

Kjo rregullore e re shfuqizon rregulloren e vjetër për paga dhe orarin e punës të personelit akademik.

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Presidenti i Bordit të Kolegjit "Pjetër Budi" - Prishtinë.

Presidenti i Bordit Drejtues

Besim AJETI